



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 prill 2011
Nr. ref.: RK112/11

AKTVENDIM PËR PAPANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 29/10

Parashtruesi

R.D.

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Rev. Nr. 295/2007**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. R. D. me banim në Viti. Në procedurën në Gjykatën Kushtetuese, ai përfaqësohet nga z. Mustafë Musa, avokat nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 295/2007, të 29 marsit 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 295/2007, të 29 marsit 2010, që ka të bëjë me të drejtat e tij pronësore për parcelën nr. 2072 në Rajac, komuna e Vitisë.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 36 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 29 prill 2010, parashtruesi parashtrroi kërkesë në Sekretariatit e Gjykatës Kushtetuese.
6. Më 23 gusht 2010, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Gjykatën Supreme që parashtruesi e konteston Aktgjykimin që e miratoi Gjykata Supreme.
7. Gjykata Kushtetuese nuk ka marrë përgjigje nga Gjykata Supreme.
8. Më 21 janar 2011, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues Robert Carolan, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Enver Hasani, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 16 tetor 2006, Gjykata Komunale në Viti, përmes Aktgjykimit të vet C.nr. 60/2006, ia njohu parashtruesit pronësinë për ngastrën kadastrale nr. 2072, në Rajac, komuna e Vitisë.
10. Më 2 maj 2007, Shaip Rexhepi kërkoji rihapjen e procedurës për rastin C. Nr. 60/05.
11. Më 4 korrik 2007, Gjykata Komunale në Viti e miratoi kërkesën e z. Shaip Rexhepi për rihapjen e procedurës dhe e anuloi një pjesë të Aktgjykimit C. Nr. 60/05, duke ia njohur e z. Shaip Rexhepi të drejtën pronësore lidhur me parcelën nr. 2073/3.
12. Më 27 gusht 2007, Gjykata e Qarkut në Gjilan, me Aktgjykimin Ac. Nr. 274/07, hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar duke thënë që gjykata e shkallës së parë nuk ka kryer asnjë shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Gjykata e Qarkut gjithashtu theksoi që e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë.
13. Më 29 mars 2010, parashtruesi kërkoji revizion nga Gjykata Supreme e Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, duke kërkuar anulimin e aktgjykimeve të gjykatave të shkallëve më të ulëta.
14. Më 20 mars 2010, Gjykata Supreme e Kosovës, përmes Aktgjykimit Rev. Nr. 295/2007, e hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për revizion. Gjykata Supreme

theksoi që e drejta materiale ishte zbatuar në mënyrë të drejtë me rastin e hedhjes poshtë të ankesës së parashtruesit si të pabazuar pasi gjykata e shkallës së parë gjeti që parashtruesi nuk e ka blerë pjesën e kontestueshme të tokës. Prandaj, Gjykata Supreme konstatoi që gjetjet ligjore dhe arsyetimi i gjykatave të shkallëve më të ulëta janë të drejta, sipas të cilave kërkesa e parashtruesit me të cilën kërkonte njohjen e të drejtës pronësore është e pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi pretendon që ka pasur shkelje thelbësore të Ligjit për Procedurën Kontestimore, posaçërisht të nenit 354, paragrafi 1 dhe 2, pika 14, në lidhje me nenin 40, paragrafi 3, të nenit 133 dhe 148, dhe gjithashtu të nenit 421, paragrafi 1, të nenit 423, paragrafi 1, nënparagrafi 1, dhe të nenit 427, paragrafi 5, të Ligjit për Procedurën Civile.

Vlerësimi i pranueshmërisë të kërkesës

16. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
17. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që sipas rregullit 36(1)(c) "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse kërkesa është qartazi e bazuar".
18. Rregulli 36 i Rregullores së punës më tej thotë:

Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

c) Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

19. Parashtruesi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij sipas Kushtetutës (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, i 31 majit 2005).
20. Gjykata Kushtetuese përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).
21. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse dëshmitë janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi ka pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).
22. Megjithatë, pas shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara nga parashtruesi, Gjykata Kushtetuese nuk gjen ndonjë dëshmi që procedurat në gjykatë ishin të padrejta apo arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Kërkesa Nr. 53363/99, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së i 31 majit 2005).

23. Prandaj, rezulton që kërkesa duhet të hidhet poshtë, qartazi, si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113(7) të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe nenin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.

Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues



Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani